



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.211/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidates së subjektit politik Lëvizja Demokratike e Kosovës (LDK) për tu zgjedhur anëtare e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Fiknete Bejta, për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet e Lokale, të mbajtura më 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.211/2025, e datës 14.10.2025, parashtruar nga Subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 14.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se më datë 12 tetor 2025, rreth orës 11:00, në ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje! në Prishtinë, kanë vërejtur se: kandidatja e subjektit politik (LDK) për tu zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të Prishtinës, znj. Fiknete Bejta në rrjete sociale ka postuar (reklama aktive) foto me përshkrimin: "Përparim Rama, Fiknete Bejta 24, numër të cilën e mban e lartcekura në listën e subjektit politik LDK për Kuvendin Komunal të Prishtinës". Me këtë veprim, kandidatja dhe subjekti politik i lartcekur, kanë shkelur dispozitat e nenit 37 parg.1 pika 1.2 i LZP-së "Bërja e fushatës në ditën e heshtjes zgjedhore". Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionit në fuqi. Si provë kanë bashkangjitur foto e postimit në rrjete sociale.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka deklaruar se postimi i përmendur është pjesë e një plani komunikimi njëmuji dhe nuk është krijuar përgatitur apo inicuar në ditën e zgjedhjeve. Ky plan është bërë publik paraprakisht dhe postimet janë përgatitur me kohë, duke u planifikuar për publikim automatik sipas kalendarit mediatik të subjektit politik. Prandaj, nuk ka pasur asnjë ndërhyrje apo veprim të qëllimshëm nga ana e kandidatit në ditën e zgjedhjeve. Ligji ndalon bërjen e fushatës në ditën e heshtjes zgjedhore, por nuk ndalon postime të planifikuara paraprakisht, e të cilat dalin çdo ditë sipas marrëveshjes dhe nuk bëhen që në ditën e zgjedhjeve të publikohen, sepse logjikisht fushata është një lloje kampanje për të cilën punohet 30 dite dhe nuk punohet që vetëm ditën e zgjedhjeve të publikohen. Dispozita ligjore ka për synim ndalimin e aktiviteteve të drejtpërdrejta, të reja, që synojnë të ndikojnë mbi vullnetin e zgjedhësve atë ditë. Në këtë rast nuk bëhet fjalë për një veprim aktiv, por për një publikim të paracaktuar, i cili nuk mund të konsiderohet si fushatë e re në ditën e heshtjes. Tutje ka shtuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova se postimi është bërë konkretisht më 12.10.2025 apo që ka qenë një veprim i qëllimshëm për të ndikuar tek votuesit. Një foto apo postim i shpërndarë në rrjetet sociale nuk përbën dëshmi të mjaftueshme për të provuar një shkelje, përderisa mungon verifikimi i kohës së publikimit origjinal. Kufizimet ligjore duhet të interpretohen ngushtë dhe vetëm për rastet kur ka fakte të qarta për shkelje. Nëse çdo material i planifikuar më herët apo çdo postim që ka qarkulluar në rrjete sociale do të konsiderohej shkelje, atëherë kjo do të sillte pasiguri juridike dhe do të penalizonte subjektet politike edhe kur nuk kanë kryer veprime aktive gjatë heshtjes zgjedhore. Po ashtu, postimi në fjalë nuk përmban as thirrje të drejtpërdrejta për të votuar ditën e zgjedhjeve, as aktivitete të reja elektorale. Ai është një informim i përgjithshëm, i përgatitur më herët, i cili nuk mund të barazohet me fushatë të ditës së zgjedhjeve. Për këto arsye, bazuar në nenin 37 par. 1 pika 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet dhe në mungesë të provave të qarta për një shkelje të ligjit, konsiderojmë se ankesa e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje është e pabazuar dhe duhet të refuzohet si e tillë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Parashtruesi i ankesës subjekti politik LVV në ankesën e tij ka theksuar se kandidatja e subjektit politik (LDK) për anëtare e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Fitnete Bejta në rrjete sociale ka postuar foto me përshkrimin: *"113 LDK Përparim Rama, Fitnete Bejta 24 për asamble komunale"*. Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 37 par. 1 pika 2 i LVP-së, apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi në provën e bashkangjitur si dëshmi nuk shihet ndokund data 12 tetor 2025 për të cilën pretendohet si datë e publikimit të fotos në rrjetin social Facebook të kandidatës Fitnete Bejta, meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të fotos. Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr.

01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilin parasheh "Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme". Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e pabazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook shihet se postimi në fjalë për të cilin pretendohet në ankesë nuk ekziston. Andaj bazuar në ato që u tha Paneli nuk ka gjetur shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtuesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar se postimi është bërë gjatë fushatës zgjedhore, që do të thotë para fillimit të heshtjes zgjedhore, ndërsa nuk ka mundur të vërtetohet se e njëjta reklamë është postuar apo është ri postuar në ditën e zgjedhjeve siç pretendohet në ankesë nga ana e subjektit ankues.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse".

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.211/2025 më datën 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.